
**RREGULLORE E
SIGURIMIT TË
BRENDSHËM TË CILËSISË
DHE AKREDITIMIT**

Miraturar nga Senati Akademik me Vendim nr. 18, datë 02.04.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
SENATI AKADEMIK

RREGULLORE
E SIGURIMIT TË BRENDSHËM TË CILËSISË DHE AKREDITIMIT

(Në përputhje me Kodin e Cilësisë ASCAL dhe standardet ESG)

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

Objekti

Kjo rregullore ka për objekt përcaktimin e parimeve, strukturave, proceseve dhe instrumenteve të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (SSBC) në Universitetin “Ismail Qemali” Vlorë, në përputhje me Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë të ASCAL-it, standardet ESG dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 2

Baza Ligjore

Kjo rregullore është hartuar dhe mbështetur në përputhje dhe në zbatim të:

- Ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor”;
- Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, miratuar me VKM nr. 531, datë 11.09.2018, i ndryshuar me VKM Nr.824, datë 24.12.2021;
- Statutit të Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë miratuar me urdhrin nr. 197, datë 01.04.2019, të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, i ndryshuar me urdhërin nr. 287, datë 30.06.2025 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit;
- Plani strategjik 2025-2030 i universitetit “ismail Qemali”, i miratuar me Vendim të Senatit Akademik të UV-së, nr.120, datë 05.12.2025;
- Manualit të procedurave dhe afateve për vlerësimin e cilësisë në kuadër të akreditimit të institucioneve të arsimit të lartë dhe programeve të studimit;
- Rregullore e Universitetit “Ismail Qemali” Vlorë, i miratuar nga Senati Akademik me Vendim nr. 20, datë 11.04.2022, i ndryshuar me Vendim SA nr.88, datë 22.09.2025;
- Aktet nënligjore në fuqi për sigurimin e cilësisë.

Neni 3

Qëllimi

Sistemi i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë synon garantimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor, shërbimeve mbështetëse dhe qeverisjes institucionale, në funksion të përmbushjes së misionit dhe vizionit të Universitetit.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Neni 4
Parimet e Sigurimit të Cilësisë

Sigurimi i brendshëm i cilësisë bazohet në këto parime:

- a. përmirësimi i vazhdueshëm (continuous improvement);
- b. përqëndrimi te studenti (student-centred learning);
- c. transparenca dhe llogaridhënia;
- d. përfshirja e palëve të interesuara;
- e. qasja e bazuar në risk;
- f. evidencë dhe gjurmueshmëri.

Neni 5
Fusha e Zbatimit

1. Rregullorja ka si fushë veprimi sigurimin e cilësisë që i referohet një procesi të vazhdueshëm, monitorimi, vlerësimi, garantimi dhe përmirësimi i cilësisë së programeve të studimit që ofrohen nga njësitë përbërëse të UV-së.
2. Kjo rregullore e shtrin efektin mbi të gjitha aspektet e veprimtarisë së njësive, që janë objekt i sigurimit të cilësisë së parashikuar sipas Kodit të Cilësisë në Arsimin e Lartë dhe rregullores për sigurimin e cilësisë në UV.
3. Kjo rregullore i shtrin efektet mbi të gjitha strukturat që kanë përgjegjësi për sigurimin e cilësisë.

KREU II
PARIMET DHE POLITIKA E CILËSISË

Neni 6
Politika e cilësisë

Universiteti miraton dhe zbaton politikën institucionale të cilësisë, e cila përditësohet periodikisht dhe zbatohet nëpërmjet objektivave të matshme, indikatorëve të performancës (KPI) dhe planeve të veprimit.

Neni 7
Sigurimi i cilësisë

1. Sigurimi i cilësisë në Universitetin "Ismail Qemali" ka tri qëllime kryesore: kontrollin e cilësisë, vlerësimin e gjendjes së cilësisë, si dhe propozime për përmirësimin e saj.
2. Sigurimi i cilësisë në UV është:
 - a. i brendshëm (prej NJSBCA së UV-së)
 - b. i jashtëm (prej ASCAL)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

3. Universiteti "Ismail Qemali" është përgjegjës për hartimin e politikave dhe procedurave për sigurimin e brendshëm të cilësisë. Sigurimi i brendshëm i cilësisë përqëndrohet në fushat:
 - a. veprimtaria tërësore e institucionit;
 - b. programet e studimit dhe mësimdhënia;
 - c. kërkimi shkencor;
 - d. arritjet e studentëve;
 - e. shërbimet për studentët;
 - f. performanca e personelit;
4. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në UV realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit (institucional dhe të programeve të studimit), vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë dhe përmirësojnë cilësinë. Raportet e vlerësimeve, të kryera nga njësia për sigurimin e brendshëm të cilësisë në UV, përdoren si burim për vlerësimin e jashtëm dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së tij.

Neni 8
Vlerësimi i cilësisë

1. Sigurimi i brendshëm i cilësisë mund të realizohet me vlerësim të përgjithshëm ose pjesëshëm. Ai realizohet nga vetë institucioni nëpërmjet:
 - Strukturave hierarkike organizative të brendshme të UV-së, të cilat planifikojnë, organizojnë dhe garantojnë zbatimin e politikave, strategjive dhe procedurave për realizimin e vizionit të tij;
 - Njësia e sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe akreditimit, cila bashkëpunon dhe mbështet komisionin e përhershëm për garantimin e standardeve të cilësisë së brendshme në nivel institucioni dhe në nivel njësie kryesore në kryerjen funksioneve të tyre;
2. Në kuadër të sigurimit të jashtëm të cilësisë, UV-ja i nënshtrohet vlerësimit periodik dhe vlerësimit krahasues institucional dhe të programeve të studimit në përputhje me legjisllacionin.

Neni 9
Vlerësimi i institucionit

1. Vlerësimi institucional ka për qëllim të analizojë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike performancën e institucionit në funksion të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies, kërkimit shkencor dhe shërbimeve ndaj studentëve dhe komunitetit.
2. Vlerësimi kryhet nga agjenci të akredituara ose organe kompetente. Institucioni harton raporte vetëvlerësimi bazuar në indikatorë të matshëm të cilësisë, duke përfshirë:
 - a. cilësinë e programeve studimore;
 - b. kualifikimin e stafit akademik;
 - c. infrastrukturën dhe burimet;
 - d. rezultatet e studentëve dhe punësimin e tyre;
 - e. feedback-un nga studentët dhe palët e interesuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Neni 10
Vlerësimi i programeve

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese të rezultateve të synuara të të nxënit duke përdorur metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit, si dhe publikohen në faqen zyrtare të institucionit.

Neni 11
Metodat dhe instrumentat e vlerësimit

Universiteti "Ismail Qemali" Vlorë në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programeve të studimit përdor:

- a. *Metoda e instrumente të tërthorta* vlerësimi si: sondazhe e intervista të studentëve, të të diplomuarve (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përfutuara nga ky program;
- b. *Metoda të drejtpërdrejta*, si: vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, vlerësime të syllabusit dhe literaturës, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.

Neni 12
Kuadri i përgjithshëm për kulturën dhe financimin e cilësisë

1. *Përfshirja*: Institucioni garanton përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve të përshtatshëm në proceset e sigurimit dhe përmirësimit të cilësisë.
2. *Integriteti*: Veprimtaria e institucionit në fushën e cilësisë udhëhiqet nga parimet e ndershmërisë, transparencës dhe përgjegjshmërisë, duke vlerësuar integritetin akademik dhe shmang çdo lloj diskriminimi apo pabarazie.
3. *Kultura e cilësisë*: Institucioni promovon dhe zhvillon vazhdimisht një kulturë të brendshme të cilësisë, e cila mbështet përmirësimin e qëndrueshëm dhe inovacionin, duke organizuar veprimtari me qëllim informimin, ndërgjegjësimin dhe rritjen e kulturës.
4. *Financimi*: Institucioni siguron burime financiare të mjaftueshme dhe të qëndrueshme për zbatimin dhe zhvillimin e proceseve të sigurimit të cilësisë. UV-ja me propozim të SA-së i paraqet BA, buxhetin për mbarëvajtjen dhe organizimin e veprimtarive në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë, si dhe përcakton buxhetin e institucionit me fonde të nevojshme për përmirësimin e cilësisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

KREU III

STRUKTURAT DHE FUNKSIONIMI I SIGURIMIT TË CILËSISË NË UV

Neni 13

Strukturat e përhershme dhe të përkohshme në fushën e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit

- A. Strukturat e përhershme të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit në UV:
- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i organizuar si Sektor i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit (SSBCA)
 - Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel institucional (KSBCI)
 - Komisionet e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në nivel njësi kryesore (KSBCF)
- B. Strukturat e përkohëshme të sigurimit të cilësisë dhe akreditimit në UV:
- Grupet e Vlerësimit të Brendshëm të institucionit
 - Grupet e Vlerësimit të Brendshëm të programeve

Neni 14

Detyrat funksionale të SSBCA në UV

- Sektori i sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe akreditimit është struktura përgjegjëse për zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e sistemit të sigurimit të brendshëm të cilësisë në Universitetin "Ismail Qemali" Vlorë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, statutin dhe rregulloren e institucionit. Ky sektor verifikon, mat dhe vlerëson cilësinë e menaxhimit, i shprehur në termat përmbledhës si më poshtë:
 - Autonomia*
 - Organizimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë*
 - Partneriteti*
 - Menaxhimi i burimeve njerëzore*
 - Menaxhimi i veprimtarisë së institucionit*
 - Menaxhimi financiar*
 - Menaxhimi i sistemeve të informacionit.*
- Në ushtrimin e funksioneve të tij, sektori realizon këto detyra:
 - Në fushën e politikave të cilësisë**
 - Zbaton në praktikë politikat dhe strategjitë e miratuara nga Rektori, Senati Akademik dhe strukturat drejtuese në fushën e sigurimit të cilësisë;
 - Kontribuon në hartimin, implementimin dhe përditësimin e politikave dhe procedurave të brendshme për sigurimin e cilësisë.
 - Siguron përputhshmërinë e veprimtarisë institucionale me kërkesat e Statutit, rregulloreve dhe legjislacionit në fuqi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

II. Pjesëmarrja në zhvillimin e mekanizmave të vlerësimit të cilësisë për të identifikuar fushat që kërkojnë përmirësim.

- a) Analizimi i feedback-ut nga studentët, stafi dhe palët e tjera të interesuara për të siguruar që standardet e cilësisë të përmbushen. Sigurimi i përputhshmërisë me standarde dhe rregullore
- b) Sigurimi që institucionet dhe programet e tij të jenë të përputhshme me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të cilësisë dhe akreditimit.
- c) Monitorimi i ndryshimeve të ligjeve, rregulloreve dhe standardeve të akreditimit dhe implementimi i tyre në institucion.

III. Në fushën e akreditimit dhe vlerësimit

- a) Sigurohet që institucioni të përmbushë kriteret dhe kërkesat për akreditim të brendshëm dhe ndërkombëtar.
- b) Koordinon proceset e akreditimit për programe, departamente ose tërë institucionin.
- c) Koordinon përgatitjen e dokumentacionit për aplikimet për akreditim dhe procese të tjera vlerësimi institucional në përputhje me kërkesat e ASCAL;
- d) Ofron mbështetje metodologjike dhe këshillimore në përgatitjen e raporteve për proceset e akreditimit institucional dhe të programeve të studimit;
- e) Mbështet proceset e rankimit dhe çdo procedurë tjetër vlerësimi të aktivitetit të universitetit;

IV. Në fushën e vlerësimit të brendshëm të cilësisë

- a) Kryen vlerësimin e brendshëm periodik të veprimtarisë akademike dhe kërkimore-shkencore, në përputhje me udhëzimet e ASCAL;
- b) Harton analiza dhe raporte mbi cilësinë, të bazuara në:
 - të dhëna statistikore;
 - evidenca dokumentare;
 - anketime dhe pyetësorë;
 - intervista me studentë dhe staf;
- c) Formulon rekomandime konkrete për përmirësimin e cilësisë së veprimtarisë institucionale.

V. Në fushën e koordinimit institucional

- a) Luan rol mbështetës, këshillues, koordinues dhe monitorues me njësitë akademike dhe administrative të universitetit;
- b) Bashkëpunon me Agjencinë e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ASCAL) dhe institucione të tjera homologe;
- c) Promovon shkëmbimin e praktikave më të mira në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar.

VI. Në fushën e monitorimit të mësimdhënies dhe studentëve

- a) Organizon dhe monitoron anketimin e studentëve për cilësinë e mësimdhënies në fund të çdo semestri;
- b) Analizon rezultatet dhe propozon masa për përmirësimin e procesit mësimor;
- c) Realizon studime gjurmuese për punësimin e të diplomuarve dhe efektivitetin e programeve të studimit nëpërmjet pyetësorit të Alumni;

VII. Në fushën e dokumentacionit dhe procedurave



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- a) Harton dhe përditëson dokumentacionin institucional të cilësisë;
- b) Ofron mbështetje për hartimin dhe zbatimin e procedurave të brendshme të sigurimit të cilësisë në përputhje me statutin dhe rregulloren;
- c) Siguron standardizimin dhe unifikimin e proceseve të cilësisë në të gjitha njësitë e universitetit.

VIII. Në fushën e raportimit dhe sistemeve të informacionit

- a) Administron dhe përditëson të dhënat në sistemet kombëtare të raportimit (ASCAL);
- b) Përgatit raporte periodike mbi cilësinë dhe performancën institucionale;
- c) Siguron transparencën e rezultateve të vlerësimit sipas procedurave institucionale.

IX. Në fushën e trajnimit dhe kulturës së cilësisë

- a) Organizon trajnime, seminare dhe aktivitete ndërgjegjësuese për sigurimin e cilësisë;
- b) Promovon kulturën institucionale të cilësisë në universitet;
- c) Rrit ndërgjegjësimin e stafit dhe studentëve për rëndësinë e cilësisë në arsimin e lartë.

X. Në fushën e vlerësimit të efektivitetit

- a) Vlerëson efektivitetin dhe impaktin e proceseve të sigurimit të cilësisë në programet e studimit;
- b) Monitoron përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në institucion.

XI. Sigurimi i transparencës dhe llogaridhënies

- a) Sigurimi që proceset e sigurimit të cilësisë dhe akreditimit të jenë transparente dhe të mbështetura me dokumentacion të plotë dhe të qartë.
- b) Ofrimi i informacionit të nevojshëm për autoritetet dhe palët e interesuara mbi masat e cilësisë dhe rezultatet e akreditimit

3. Sektori gëzon autonomi funksionale në ushtrimin e detyrave të tij dhe ka akses në të gjitha të dhënat institucionale të nevojshme për realizimin e funksioneve të tij, në përputhje me legjislacionin në fuqi, pas miratimit nga ana e rektorit.
- 4.

Neni 15

Detyrat funksionale të specialistëve SSBCA në UV

Detyrat funksionale të specialistëve në përbërje të SSBCA:

A. Specialist akreditimi dhe raportimi me ASCAL:

1. Koordinimi i procesit të akreditimit

- a. *Menaxhimi i procesit të akreditimit:* Pjesëmarrja në përgatitjen e dokumentacionit dhe materialeve të nevojshme për kërkesat e akreditimit për programet akademike dhe institucionin.
- b. *Krijimi dhe mbikëqyrja e ekipit të akreditimit:* Koordinimi i grupeve të punës të cilët mblidhen për të shqyrtuar dhe analizuar përputhshmërinë e programeve dhe aktiviteteve me standardet e akreditimit.
- c. *Përgatitja e dokumenteve të nevojshme për aplikim:* Sigurimi që të gjitha dokumentet dhe provat e kërkuara për procesin e akreditimit të përgatiten dhe të dërgohen në kohë dhe sipas standardeve të përcaktuara.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Raportimi me ASCAL dhe institucionet përkatëse

- a. *Përgatitja dhe dërgimi i raporteve*: Përgatitja e raporteve periodike që duhet të dërgohen në ASCAL për të dokumentuar përparimin dhe rezultatet e implementimit të standardeve të akreditimit. Përditëson rregullisht informacionin në sistemin e menaxhimit të informacionit (AMS).
- b. *Koordinimi i komunikimeve me ASCAL*: Mbajtja e lidhjeve të vazhdueshme me ASCAL për të siguruar që proceset e akreditimit të jenë në përputhje me rregullat dhe kërkesat e agjencisë dhe për të marrë udhëzime dhe rekomandime kur është e nevojshme.
- c. *Pjesëmarrja në mbledhje dhe aktivitete me ASCAL*: Pjesëmarrja në takime dhe aktivitete që lidhen me akreditimin dhe vlerësimin e cilësisë për të siguruar që institucioni të qëndrojë në përputhje me kërkesat për akreditim.

3. Sigurimi i zbatimit të standardeve të Cilësisë dhe Akreditimit

- a. *Implementimi i standardeve të akreditimit*: Sigurimi që të gjitha programet dhe aktivitetet e institucionit të jenë në përputhje me standardet e akreditimit të përcaktuara nga ASCAL dhe organizmat ndërkombëtarë.
- b. *Monitorimi i zhvillimit të programeve akademike*: Mbikëqyrja e zhvillimit të programeve dhe aktiviteteve akademike për të siguruar që ato plotësojnë kërkesat dhe standardet e akreditimit.
- c. Të verifikojë, të masë dhe të vlerësojë objektivat kryesore të menaxhimit Institucional.
- d. Të verifikojë, të masë dhe të vlerësojë cilësitë e menaxhimit të shprehura në termat e autonomise dhe organizimit të Institucioneve të Arsimit të Lartë.
- e. Të verifikojë, të masë dhe të vlerësojë cilësitë e menaxhimit të shprehura në termat e partneriteteve të realizuar në kuader të ndërkombëtarizimit të institucionit.
- f. *Konsultimi dhe mbështetje për departamentet akademike*: Ofrimi i mbështetjes për departamentet akademike në përputhje me proceset e akreditimit dhe sigurimin e cilësisë, duke siguruar që ato të zbatojnë praktikatat më të mira dhe të përmbushin kriteret e kërkuara.

4. Përgatitja dhe zbatimi i planeve të cilësisë

- a. *Hartimi i planëve të cilësisë*: Përgatitja e planeve dhe strategjive për përmirësimin e cilësisë, duke përfshirë monitorimin dhe vlerësimin e aktiviteteve të ndryshme dhe të dhënave relevante.
- b. *Organizimi i aktiviteteve të trajnimit*: Ndihma në organizimin e trajnimeve dhe aktiviteteve edukative për stafin akademik dhe administrativ lidhur me akreditimin dhe sigurimin e cilësisë.
- c. *Vlerësimi i rezultateve dhe implementimi i rekomandimeve*: Monitorimi dhe vlerësimi i progresit të aktiviteteve të cilësisë dhe implementimi i rekomandimeve të dala nga proceset e akreditimit.

5. Mbikëqyrja dhe vlerësimi i rekomandimeve dhe përshtatjeve

- a. *Analizimi i rezultateve të auditimeve*: Analizimi i raportimeve dhe auditimeve nga ASCAL dhe organizatat ndërkombëtare për akreditim dhe përgatitja e reagimeve dhe masave për përmirësimin e situatës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

- b. *Ndihma në implementimin e rekomandimeve:* Pjesëmarrja në implementimin e rekomandimeve të cilat dalin nga vlerësimet dhe auditimet e akreditimit për të siguruar përmirësime dhe rritje të cilësisë.
6. Sigurimi i përshtatjes me rregullat dhe legjislacionin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - a. *Përputhshmëria me legjislacionin:* Sigurimi që institucionet të përputhen me legjislacionin dhe rregullat kombëtare dhe ndërkombëtare për akreditimin dhe cilësinë në arsimin e lartë.
 - b. Siguron që detyrimet kombëtare dhe evropiane të jenë pjesë e praktikës së punës dhe pjesë e jetës së Universitetit "Ismail Qemali" Vlorë.
 - c. *Monitorimi i ndryshimeve ligjore dhe rregullatore:* Pjesëmarrja në ndjekjen e ndryshimeve të mundshme ligjore dhe rregullatore që mund të ndikojnë në procesin e akreditimit dhe implementimin e standardeve të cilësisë.
7. Ofrimi i Informacionit dhe Mbështetje për Stafin dhe Studentët
 - a. *Sigurimi i transparencës në procesin e akreditimit:* Ofrimi i informacionit të qartë dhe të saktë për stafin dhe studentët mbi procesin e akreditimit dhe rëndësinë e tij për zhvillimin e programeve dhe përmirësimin e cilësisë akademike.
 - b. *Pjesëmarrja në aktivitete sensibilizuese:* Organizatimi i aktiviteteve për sensibilizimin e stafit dhe studentëve për rëndësinë e akreditimit dhe cilësisë në arsimin e lartë.
8. Raportimi dhe pjesëmarrja në procesin e vlerësimit të vetëvlerësimit
 - a. *Ndihma në procesin e vetëvlerësimit:* Pjesëmarrja dhe mbështetja në proceset e vetëvlerësimit që realizohen për përgatitjen e kërkesave të akreditimit dhe vlerësimit nga ASCAL.
 - b. *Krijimi dhe përgatitja e raporteve të vetëvlerësimit:* Sigurimi që raporte të vetëvlerësimit të jenë të plota, të sakta dhe të përmbushin kërkesat përpara auditeve të jashtme dhe akreditimeve.
 - c. Mbledh raportet mujore, 6-mujore dhe vjetore të Fakulteteve, Departamenteve dhe njësive në Rektorat dhe udhëheq hartimin e Raportit të përbashkët të SA dhe BA për Ministrinë e Arsimit.

B. Specialist raportimi

Mbledh, analizon dhe përgatit raporte për aktivitete të ndryshme të universitetit. Është përgjegjës për të siguruar që informacioni dhe të dhënat e mbledhura të jenë të sakta, të përditësuara dhe të paraqitura në mënyrë efektive për të mbështetur vendimmarrjen dhe transparencën e institucioni.

1. Përgatitja e raporteve të rregullta dhe sipas kërkesës.
 - a. *Përgatitja e raporteve mujore, tremujore dhe vjetore:* Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për përgatitjen e raporteve të zakonshme për aktivitetet dhe zhvillimet në universitet.
 - b. *Përgatitja e raporteve për autoritetet e jashtme:* Hartimi i raporteve të nevojshme për agjencitë e akreditimit, Ministrinë e Arsimit, dhe organizmat ndërkombëtarë, si dhe sigurimi që ato të jenë të sakta dhe të përmbushin kërkesat përkatëse.
 - c. *Raportimi mbi përmbushjen e objektivave të strategjisë së universitetit:* Sigurimi që raportet e përgatitura të pasqyrojnë arritjet e universitetit në lidhje me objektivat strategjike dhe planifikimin afatgjatë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

2. Mbledhja dhe analiza e të dhënave
 - a. *Mbledhja e të dhënave nga departamentet dhe njësitë e tjera:* Koordinimi me departamentet dhe njësitë e ndryshme të universitetit për mbledhjen e të dhënave dhe informacionit të nevojshëm për përgatitjen e raporteve.
 - b. *Analizimi i të dhënave dhe informacionit:* Përdorimi i mjeteve të analitikës për të analizuar të dhënat dhe për të nxjerrë përfundime mbi performancën e aktiviteteve të ndryshme në universitet, si dhe për të identifikuar trende dhe nevoja për përmirësim.
 - c. *Përpunimi i statistikave dhe informacionit:* Sigurimi që informacioni dhe statistikatat të jenë të sakta dhe të pasqyrojnë realitetin e aktiviteteve dhe performancës së universitetit.
3. Përgatitja e dokumenteve për mbledhjet dhe takimet
 - a. *Përgatitja e materialeve për takimet e rektoratit, senatit dhe bordit:* Përgatitja e raporteve dhe materialeve që do të diskutohen në mbledhjet e strukturave drejtuese, duke përfshirë analizën e performancës dhe rekomandime për veprime të mëtejshme.
4. Raportimi dhe komunikimi me palët e jashtme
 - a. *Raportimi ndaj institucioneve të akreditimit dhe autoriteteve:* Përgatitja dhe dërgimi i raporteve për organet e akreditimit si dhe për autoritetet qeveritare dhe administratën lokale në lidhje me performancën dhe zhvillimin e universitetit.
 - b. *Komunikimi me donatorët dhe partnerët e jashtëm:* Ofrimi i raporteve dhe përditësimeve në lidhje me aktivitetet e financuara nga burime të jashtme, duke siguruar që të gjitha kërkesat e raportimit të plotësohen në kohë.
5. Përgatitja e raporteve të cilësisë dhe performancës
 - a. *Monitorimi i indikatorëve të cilësisë:* Mbikëqyrja dhe raportimi i të dhënave mbi cilësinë e programeve akademike dhe shërbimeve në universitet, duke përfshirë indikatorët e performancës të bazuar në rezultatet dhe matjet e cilësisë.
 - b. *Raportimi mbi standardet e akreditimit:* Sigurimi që universiteti të raportojë për përputhshmërinë e tij me standardet kombëtare dhe ndërkombëtare të akreditimit dhe cilësisë, si dhe përgatitja e raporteve që pasqyrojnë përparimin e tij.
6. Mbështetje për planifikimin dhe vendimmarrjen strategjike
 - a. *Pjesëmarrja në përgatitjen e raporteve për planifikim strategjik:* Asistimi në përgatitjen e raporteve që mbështesin proceset e planifikimit strategjik të universitetit, duke siguruar që të dhënat të jenë të plota dhe të sakta për të ndihmuar vendimmarrjen.
 - b. *Analiza e performancës afatshkurtër dhe afatgjatë:* Analizimi i të dhënave për të ndihmuar në vlerësimin e progresit të planit strategjik dhe realizimin e objektivave të universitetit.
7. Sigurimi i transparencës dhe lidhjes me komunitetin universitar
 - a. *Publikimi i raporteve për komunitetin universitar:* Sigurimi që raportet dhe të dhënat të jenë të disponueshme për stafin, studentët dhe palët e tjera të interesuara për të mbajtur një nivel transparence të lartë.
 - b. *Ofrimi i informacionit për aktivitetet dhe rezultatet e universitetit:* Ndihma në publikimin e informacionit mbi aktivitetet dhe arritjet e universitetit përmes kanaleve të komunikimit të brendshëm dhe të jashtëm.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

C. Specialist sondazhesh

1. Krijimi dhe zhvillimi i sondazheve

- a. *Dizajnimi i sondazheve:* Krijimi dhe zhvillimi i sondazheve të nevojshme për të mbledhur informacion mbi aspekte të ndryshme të funksionimit të universitetit, siç janë cilësia e mësimdhënies, kënaqësia e studentëve, vlerësimi i shërbimeve administrative, etj.
- b. *Kujdesi për formulimin e pyetjeve:* Sigurimi që pyetjet e sondazheve të jenë të qarta, të sakta dhe të matshme për të mbledhur informacion të vlefshëm dhe të besueshëm.
- c. *Përdorimi i mjeteve dhe teknologjive për sondazhe:* Zgjedhja e mjeteve dhe platformave të përshtatshme për administrimin dhe mbledhjen e të dhënave përmes sondazheve (p.sh. Google Forms, SurveyMonkey, etj.).

2. Administrimi dhe koordinimi i sondazheve

- a. *Koordinimi me departamentet dhe njësitë e tjera:* Bashkëpunimi me departamentet akademike, administratën dhe shërbimet studentore për të planifikuar dhe realizuar sondazhe të ndryshme që i shërbejnë nevojave të universitetit.
- b. *Drejtimi i procesit të mbledhjes së të dhënave:* Organizimi dhe administrimi i sondazheve për studentët, stafin akademik dhe administrativ, duke siguruar që të gjitha palët të jenë të informuara dhe të motivuara për të marrë pjesë.
- c. *Monitorimi i procesit të mbledhjes së të dhënave:* Mbikëqyrja e mbledhjes së të dhënave për të siguruar që sondazhet të realizohen në kohë dhe në mënyrë efikase.

3. Përpunimi dhe analiza e të dhënave të sondazheve

- a. *Përpunimi i të dhënave:* Përdorimi i teknikave statistikore dhe mjeteve për analizimin e të dhënave të mbledhura nga sondazhet, si për shembull analiza e frekuencës, korelacionet, apo analiza e grupimeve.
- b. *Përgatitja e raporteve analitike:* Hartimi i raporteve që pasqyrojnë gjetjet nga sondazhet dhe analiza e tyre, duke përfshirë informacion të qartë dhe të kuptueshëm për të gjithë palët e interesuara.
- c. *Identifikimi i trendeve dhe rekomandimeve:* Analizimi i rezultateve për të nxjerrë trende dhe për të formuluar rekomandime për përmirësimin e aktiviteteve dhe shërbimeve të universitetit.

4. Raportimi dhe paraqitja e rezultateve

- a. *Prezantimi i rezultateve:* Ofrimi i raporteve dhe analizave për menaxhmentin, departamentet akademike dhe organet e tjera të universitetit që mund të përdorin rezultatet për të marrë vendime strategjike.
- b. *Përgatitja e raporteve për akreditim dhe cilësi:* Sigurimi që rezultatet e sondazheve të mbështesin përpjekjet e universitetit për akreditim dhe për përmirësimin e cilësisë akademike dhe administrative.
- c. *Komunikimi me komunitetin universitar:* Informimi i studentëve, stafit dhe palëve të tjera të interesuara mbi rezultatet e sondazheve dhe ndryshimet që mund të ndërmerren si pasojë e tyre.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

5. Koordinimi i sondazheve të kënaqësisë së studentëve
 - a. *Kërkimi i mendimeve dhe sugjerimeve nga studentët:* Krijimi dhe administrimi i sondazheve që matin kënaqësinë e studentëve me shërbimet, mësimdhënien, dhe infrastrukturën e universitetit.
 - b. *Përpunimi i feedback-ut të studentëve:* Analizimi i mendimeve dhe sugjerimeve të studentëve dhe përgatitja e rekomandimeve për përmirësimin e eksperiencës akademike dhe studentore.
6. Mbështetje për vlerësimin e cilësisë dhe strategjive të universitetit
 - a. *Pjesëmarrja në vlerësime të brendshme:* Asistimi në proceset e vlerësimit të cilësisë në departamente dhe programe akademike përmes sondazheve të drejtuara ndaj studentëve dhe stafit.
 - b. *Monitorimi i implementimit të rekomandimeve:* Sigurimi që rekomandimet e dalura nga sondazhet të implementohen dhe të monitorohen për të siguruar përmirësime të vazhdueshme.
7. Organizimi i aktiviteteteve të sondazheve dhe anketave
 - a. *Planifikimi i periudhës së sondazheve:* Vendosja e periudhave të duhura për realizimin e sondazheve, për të siguruar pjesëmarrje të lartë dhe që sondazhet të jenë të përshtatshme me kalendarin akademik dhe periudhat e tjera.
 - b. *Përgatitja e materialeve promovuese:* Krijimi i materialeve që informojnë studentët dhe stafin për rëndësinë e sondazheve dhe për pjesëmarrjen e tyre.
8. Pjesëmarrja në hartimin e strategjive të kërkimit dhe cilësisë
 - a. *Sigurimi i të dhënave për strategjitë e cilësisë:* Mbledhja e informacionit të nevojshëm nga sondazhet që do të përdoret për hartimin dhe përmirësimin e strategjive dhe planeve të cilësisë në universitet.
 - b. *Ofrimi i informacionit mbi trende dhe përmirësime:* Identifikimi i trendeve dhe çështjeve që dalin nga sondazhet dhe ndihma në formulimin e strategjive për përmirësimin e cilësisë dhe eksperiencës universitare.

Neni 16

Komisioni i sigurimit të brendshëm të cilësisë në nivel institucional (KSBCI)

1. Komisioni i përhershëm i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Institucional është organ kolegjal, që funksionon në nivel institucional në mbështetje të proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe akreditimit.
2. KSBCI ka për qëllim:
 - a) sigurimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së UV-së me standardet e cilësisë dhe objektivat strategjike të vendosura nga MA dhe institucione akredituese ndërkombëtare.
 - b) garantimin e standardeve të cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe shërbime;
 - c) mbështetjen e proceseve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm;
 - d) monitorimin e përputhshmërisë me standardet e ASCAL;
 - e) përmirësimin e vazhdueshëm të performancës institucionale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

3. KSBCI përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i UV-së (nga një anëtar për çdo fakultet) që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
4. Funkcionet e këtij komisioni lidhen me garantimin e standardeve shtetërore të cilësisë si dhe në Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Hapësirën Europiane të Arsimit të Lartë (EHEA). Komisioni ushtron kryesisht këto funksione:
 - a) Harton politikat dhe planin e zhvillimit institucional për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe e dërgon për miratim në Senatin Akademik;
 - b) Harton Rregulloren e Sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UV dhe e dërgon për miratim në Senatin Akademik;
 - c) Vlerëson në mënyrë periodike përmbushjen e standardeve shtetërore të cilësisë në nivel institucioni si dhe raporton përpara Senatin Akademik për rezultatet e vlerësimit.
 - d) Harton rekomandime në lidhje me përmirësimin e performancës së institucionit në përmbushje të standardeve shtetërore të cilësisë në nivel institucioni si dhe e dërgon për miratim në Senatin Akademik;
 - e) Harton rekomandime në bashkëpunim me KSBCF në mbështetje të rezultateve të nxjerr prej instrumentave të ndryshëm që NJSBC/njësia kryesore përdor për sigurimin e cilësisë, si dhe i përcjell për miratim në Senatin Akademik;
 - f) Vlerëson në mënyrë periodike instrumentat ekzistues për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe propozon përmirësimet e nevojshme sipas rastit;
 - g) Harton raportin e vetëvlerësimit në kuadër të akreditimit institucional, si pjesë përbërëse e GVB-së që ngrihet prej institucionit për këtë qëllim;
 - h) Propozon pranë SA-së planin e veprimit në përmbushje të rekomandimeve të Bordit të Akreditimit në kuadër të akreditimit institucional si dhe monitoron zbatimin e tij;
 - i) Bashkëpunon me struktura të tjera në nivel institucioni si dhe bashkëpunorë të jashtëm për organizimin e aktiviteteve në përmbushje të standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë;
 - j) Brenda muajit dhjetor të çdo viti kalendarik, harton dhe publikon raportin vjetor të veprimtarisë së tij me gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve akademik dhe administrative.
 - k) Kryen çdo funksion tjetër të ngarkuar nga autoritetet dhe organet drejtuese të UV-s në fushën e sigurimit të cilësisë.
5. Në rast se rekomandimet nuk zbatohen, KSCBI informon, sipas rastit:
 - a) Këshillin e Etikës;
 - b) Senatin Akademik;
 - c) Rektorin e universitetit,për marrjen e masave përkatëse.
6. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj KSBCI mbështetet dhe bashkërendon punën me strukturat/organet e tjera në nivel njësie kryesore/nivel institucioni të ngritura me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 17

Komisionet e sigurimit të brendshëm të cilësisë për çdo fakultet (KSCBF)

1. Komisioni i përhershëm i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në fakultet është organ kolegjal, që funksionon në nivel njësie kryesore në mbështetje të proceseve të sigurimit të brendshëm të cilësisë dhe akreditimit.
2. KSBCF ka për qëllim:
 - a) *sigurimin e përputhshmërisë së veprimtarisë së fakultetit me standardet e cilësisë dhe objektivat strategjike të universitetit.*
 - b) *garantimin e standardeve të cilësisë në mësimdhënie, kërkim shkencor dhe shërbime;*
 - c) *mbështetjen e proceseve të vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm;*
 - d) *monitorimin e përputhshmërisë me standardet e ASCAL;*
 - e) *përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së fakultetit.*
3. Ky komision përbëhet nga nga 5 (pesë) anëtarë, nga të cilët 4 (katër) janë anëtarë nga personeli akademik i njësisë kryesore që i përkasin kategorisë "Profesor" ose/ dhe "Lektor" dhe 1 (një) anëtar është përfaqësues i studentëve.
4. Funksionet e këtij komisioni lidhen me garantimin e standardeve shtetërore të cilësisë për programet e studimit si dhe shërbimet ndaj studentëve. Komisioni ushtron kryesisht këto funksione:
 - a) Ndjek zbatimin në nivel njësisë kryesore të politikave të miratuara prej SA-së dhe organeve të tjera kolegjiale në fushën e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimin e programeve të studimit.
 - b) Rishikon në mënyrë periodike instrumentat që përdor njësia kryesore për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe propozon përmirësimet e nevojshme sipas rastit;
 - c) Realizon studime për të vlerësuar efikasitetin e programeve të studimit të ofruara nga Njësia Kryesore;
 - d) Harton rekomandime në mbështetje të rezultateve të nxjerr prej instrumentave të ndryshëm që NJSBC/njësia kryesore përdor për sigurimin e cilësisë, si dhe i përcjell për miratim pranë KSBCI;
 - e) Monitoron zbatimin e planit të masave për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies për lëndët e cdo programi studimi.
 - f) Mbështet procesin e vlerësimit të jashtëm për akreditimin e programeve të studimit të ofruara nga Njësia Kryesore, duke ofruar ekspertizë GVB-ve në hartimin e RVB-së;
 - g) Miraton paraprakisht sipas rastit, planet e veprimit në përmbushje të rekomandimeve prej vlerësimit të jashtëm në kuadër të akreditimit të programeve të studimit që ofron njësia kryesore, si dhe ndjek zbatimin e tyre;
 - h) Monitoron planet e veprimit në përmbushje të rekomandimeve të Bordit të Akreditimit për akreditimin e programeve të studimit;
 - i) Bashkëpunon me struktura të tjera në nivel institucioni si dhe bashkëpunëtorë të jashtëm për organizimin e aktiviteteve në përmbushje të standarteve për programet e studimit;
 - j) Brenda muajit shtator të çdo viti kalendarik, harton dhe publikon raportin vjetor të veprimtarisë së tij me gjetjet dhe rekomandimet për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve akademik dhe administrative në njësinë kryesore përkatëse;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

- k) Hartojnë rregulloren e vet si dhe planin e punës;
- l) Kryen çdo funksion tjetër të ngarkuar nga autoritetet dhe organet drejtuese të UV-s në fushën e sigurimit të cilësisë të programeve të studimit;
- l) Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj KSBCF mbështetet nga strukturat/organet e tjera në nivel njësie kryesore/nivel institucioni të ngritura me qëllim sigurimin e brendshëm të cilësisë.

Neni 18

Grupi i vlerësimit të brendshëm të institucionit

1. Në kuadrin e vlerësimit të brendshëm, në nivel rektorati ngrihet dhe funksionon Grupi i Vlerësimit të Brendshëm (GVB) i UV-së, i cili ushtron veprimtarinë vetëm në periudhën e kryerjes së vlerësimit të brendshëm institucional.
2. GVB institucional mund të ketë në përbërje të vet:
 - a) Zëvendësrektorë;
 - b) Zëvendësdekanë nga të gjitha njësitë kryesore;
 - c) Specialistët SSBCA;
 - d) Specialist të sektorit të financave;
 - e) Specialist të sektorit të kërkimit shkencor dhe projekteve;
 - f) Studentë;
3. GVB-ja institucionale ka si detyrë kryerjen e vlerësimit të brendshëm dhe hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm institucional. GVB-ja ka autonomi operative dhe duhet t'i sigurohet akses në të gjitha të dhënat institucionale;
4. GVB-ja kryen vlerësimin e brendshëm sipas procedurave të parashikuara në Manualin e Cilësisë në UV dhe i komunikon rezultatet e vlerësimit rektorit dhe ASCAL.

Neni 19

Grupi i vlerësimit të brendshëm të programit të studimit

1. Në kuadrin e vlerësimit të brendshëm, në njësitë bazë ngrihet dhe funksionon Grupi Vlerësimit të Brendshëm (GVB) i programeve të studimit, i cili ushtron veprimtarinë vetëm në periudhën e kryerjes së vlerësimit të brendshëm. Kur programi i studimit zhvillohet midis dy ose më shumë departamenteve, këto të fundit duhet të kenë të paktën 1 (një) anëtar në GVB;
2. GVB-ja e programeve të studimit ka si detyrë kryerjen e vlerësimit të brendshëm dhe hartimin e raportit të vlerësimit të brendshëm për çdo program studimi. GVB-ja ka autonomi operative dhe duhet t'i sigurohet akses në të gjitha të dhënat e njësisë;
3. GVB-ja kryen vlerësimin e brendshëm sipas procedurave të parashikuara në Manualin e Cilësisë në UV dhe i komunikon rezultatet e vlerësimit Dekanatit/Drejtorisë, drejtuesit të njësisë kryesore dhe të njësisë bazë si dhe personelit akademik të njësisë/njësive bazë që mbulon/jnë programin e studimit, personelit ndihmës-administrativ dhe përfaqësuesve të studentëve;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

Neni 20

Pyetësorët dhe sondazhet e organizuara nga SSBCA

1. SSBCA organizon periodikisht vlerësime për:
 - a) Cilësinë e programeve të studimit
 - b) Cilësinë e shërbimeve administrative prej stafit ndihmës-akademik dhe administrativ, institucionale dhe në njësitë kryesore.
 - c) Aspekte të funksionimit institucional, sipas kërkesave të Rektoratit, dekanateve dhe Këshillit Studentor.
 - d) Çështje të ngritjes së politikave të zhvillimit të UV-së.
2. Këto vlerësime realizohen nëpërmjet:
 - a) Pyetësorëve të cilësisë së mësimdhënies;
 - b) Pyetësorë të alumni;
 - c) Fokus-grupeve me studentë;
 - d) Pyetësorë të shërbimeve të ofruara në UV;

Neni 21

Organizimi i pyetësorëve

A. Pyetësorët e cilësisë së mësimdhënies

1. Jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të semestrit apo para sezonit të provimeve, NJSBCA e UV-së harton pyetësorin studentor tip, për cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi studimi;
2. Pyetësori i hartuar shpërndahet online nëpërmjet sistemit të brendshëm të informacionit të UV-së (UNVIMAS), jo më vonë se 10 (dhjetë) ditë para përfundimit të semestrit apo para sezonit të provimeve;
3. Kur vlerësohet i nevojshëm, pyetësori studentor mund të hartohet edhe për tematika të veçanta;
4. Rezultatet e përfuara nga organizimi i pyetësorit studentor, përcillen nga NJSBCA-ja tek Rektorati, njësitë kryesore dhe njësitë bazë.

B. Pyetësorët alumni

1. Pyetësorët për studentët alumni shpërndahen elektronikisht në adresat email të tyre, sipas Databazës ALUMNI, që menaxhohet nga sektori i Karrierës, Studentëve dhe Alumnit.
2. Pyetësori realizohet së paku 1 (një) herë në 3 (tri) vjet.
3. Rubrikat e pyetësorit përmbajnë pyetje mbi:
 - a) Programet akademike të UV-së
 - b) Veprimtarinë ekstrakurrikulare të UV-së
 - c) Cilësinë e shërbimeve të ofruara nga UV
 - d) Tregun e punës
 - e) Rekomandime mbi politikat e zhvillimit institucional
 - f) Tematika të veçanta, sipas kërkesës nga njësitë bazë dhe strukturat e UV-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

4. Rezultatet e përfuara nga organizimi i pyetësorit alumni, përcillen nga NJSBC-ja tek Rektorati, njësitë kryesore dhe njësitë bazë.

C. Pyetësorët për shërbimet e ofruara në UV

1. Pyetësorët për shërbimet e ofruara në UV shpërndahen elektronikisht në adresat elektronike të (@univlora.edu.al).
2. Pyetësori realizohet së paku një herë në vit.
3. Rubrikat e pyetësorit përmbajnë pyetje mbi administrimin akademik dhe institucional të UV-së, si dhe politikat e zhvillimit institucional.
4. Rezultatet e përfuara nga organizimi i pyetësorit të personelit UV, përcillen nga NJSBC-të tek Rektorati, njësitë kryesore dhe njësitë bazë.

Neni 22

Raportet për sigurimin e brendshëm të cilësisë

1. Brenda 20 (njëzetë) ditëve nga përfundimi i vitit akademik, njësitë bazë hartojnë raportin e vlerësimit të veprimtarisë mësimore-shkencore (analiza vjetore) dhe ia përcjellin Dekanatit dhe KSCBF të njësisë kryesore. Raportet duhet të përfshijnë jo vetëm përshkrime statistikore sipas Udhëzimit përkatës të MA, por edhe rekomandime për përmirësimin e cilësisë të përcaktuara në udhëzuesin mbi vlerësimin dhe zhvillimin e cilësisë së autoritetit shtetëror përkatës;
2. Njësitë kryesore hartojnë raportin përmbledhës në nivel njësie kryesore, e më pas përcillet tek NJSBC e UV-së;
3. Pas dorëzimit të raporteve të vlerësimit nga njësitë kryesore, NJSBC harton raportin e vlerësimit institucional vjetor, i cili përcillet për miratim në Senatin Akademik dhe Bordin e Administrimit;
4. Miratimi i raportit të vlerësimit institucional vjetor bëhet para përfundimit të vitit kalendarik dhe përcillet shkresërisht dhe elektronikisht në ministrinë përgjegjëse të arsimit.

Neni 23

Publikimi i rezultateve të vlerësimit

1. Publikimi i rezultateve të raporteve të vlerësimeve është i detyrueshëm.
2. Raporti i Vlerësimit Institucional vjetor, pas miratimit të tij nga Senati Akademik dhe Bordi i Administrimit, publikohet në faqen zyrtare të UT-së në seksionin e Programit të Transparencës.
3. Publikimi i rezultateve të pyetësorëve bëhet nga NJSBCA e UV-së, brenda 30 ditëve nga hartimi i Raportit Përfundimtar, i cili publikohet në faqen zyrtare të UV-së në seksionin e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë.

Neni 24

Plani i masave

1. Me qëllim përmirësimin e problemeve të evidentuara gjatë vlerësimit të brendshëm dhe të jashtëm, SSBCA dhe njësitë bazë përgatisin planet e masave.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
SENATI AKADEMIK

2. Planet e masave hartohen pasi të jenë shqyrtuar rekomandimet e lëna në Raportin e Vlerësimit Institucional dhe të Programeve të Studimit.
3. Në këto plane masash përcaktohen detyrat që duhet të realizohen dhe përgjegjësitë për realizimin e tyre, si dhe afatet dhe burimet për realizimin e tyre;
4. Planet e masave në nivel institucional kryesore propozohen nga SSBCA dhe miratohen nga Rektorati.
5. Planet e masave në nivel njësie kryesore propozohen nga njësia bazë dhe miratohen nga Dekanati.

KREU IV

Dispozita të fundit

Neni 25

1. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të saj nga Senati Akademik i universitetit “Ismail Qemali” Vlorë dhe publikimit në faqen zyrtare të universitetit;
2. Ndryshimi i rregullores, (shtesë ose heqje neni) realizohet vetëm me vendim senati akademik.

KRYETAR I SENATIT AKADEMIK

PROF.DR. AURELA SALIAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI “ISMAIL QEMALI” VLORË
SENATI AKADEMIK

LISTA E SHKURTESAVE:

- ASCAL* – Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë
ESG – European Standards and Guidelines
SSBCA – Sektori i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit
UV – Universiteti i Vlorës
NJSBCA – Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Akreditimit
BA – Bordi Administrimit
SA – Senati Akademik
KSBCI – Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Institucional
KSBCF - Komisioni i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në Fakultet
EHEA – European Higher Education Area
MA – Ministria e Arsimit
GVB – Grupi i vlerësimit të brendshëm
RVB – Raporti i vlerësimit të brendshëm
UNVIMAS - Sistemit Kompjuterik University Virtual Management System
AMS – Ascal Manegment System